



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Kuvendi i Komunës-

01 - Nr. 05-16-9257/12.
Kaçanik; 30..05. 2012.

Në bazë të neneve 5, 12 dhe 17 lidhur me nenin 40.2 (a) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(a) të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më 30 .05.2012, aprovon këtë:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr.05-8253/2010.-
PËR PËRCAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

1.1. Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01Nr.05-5318/2010 -Për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Kaçanikut, e aprovuar nga kuvendi i komunës së Kaçanik më datë: 30.06.2010.

1.2. Nenet dhe paragrafet e Rregullorës që ndryshohen, janë paraqitur në nenin 2. të kësaj Rregullorje, ku fillimisht është përshkruar teksti ekzistues i cili tekst ndryshohet dhe plotësohet(zëvendësohet) me tekstin e ri të propozuar për ndryshime.

Neni 2

2.1. Teksti që shlyhet është te neni 4, paragrafi 4.2.2. – Orari i punës së shitorëve e tjera tregëtare jo ushqimore fillon prej orës 08. 00 – 20.00.

Të dieleve nuk punojnë shitorët tregëtare për shitjen e artikujëve jo ushqimor.

Zëvendësimi me tekstin e ri: Orari i punës së shitorëve e tjera tregëtare jo ushqimore fillon, për:

- periudhën verore prej orës **08.00 - 22.00**
- periudhën dimërore prej orës **08.00 - 20.00.**

Të dieleve nuk punojnë shitorët tregëtare për shitjen e artikujëve jo ushqimor.

Neni 3

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi
